



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - * Aktivitetet tjera

Prill 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse, procedimi i provave në procedurën kundërvajtëse

Më 02 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temën “Fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me fillimin dhe zhvillimin e procedurës kundërvajtëse si dhe vlerësimin e drejtë të provave në procedurën kundërvajtëse.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan çështjet si përgjegjësitë kundërvajtëse, masat e veçanta të kundërvajtjes, kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve, sanksioneve për kundërvajtje, procedura për të mitur, si dhe veprimet e gjykatës pas pranimit të kërkesës për fillimin e procedurës.

Trajnimi u fokusua kryesisht në elaborimin për kërkesën për fillimin e procedurës, si mundet të

fillohet procedura, vendimi për fillimin e procedurës, ndërprerja e procedurës, përmbajtja e kërkesës, shkaqet e hedhjes së kërkesës, si dhe organet e autorizuara për paraqitjen e kërkesës.

Më tej në mënyrë të hollësishme u trajtuan administrimi i provave, parimet udhëheqëse juridike gjatë administrimit të provave, marrja në pyetje e të pandehurit, marrja në pyetje e dëshmitarit, personat e liruar nga obligimi për të dëshmuar, pyetjet lidhur me faktet vendimtare si dhe ballafaqimi .

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike të diskutojnë dhe adresojnë sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë punës së tyre praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



E DREJTA NË PRONË – Pronësia e Përbashkët, Bashkëpronësia dhe Pasuria e Përbashkët

Më 3 prill 2019 në Pejë si dhe me 5 prill 2019 në Prishtinë, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme me përkrahjen e USAID-it - "Programi i të Drejtave Pronësore – Property Rights Programe" organizoj trajnimet e radhës regjionale me temë: "E Drejta në pronë: Pronësia e Përbashkët, Bashkëpronësia dhe Pasuria e Përbashkët".

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve mbi bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët në Kosovë dhe trendët bashkëkohore si dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi në vendosjen e kontesteve pronësoro juridike.

Në pjesën e parë të këtyre trajnimeve janë trajtuar: Bashkëpronësia sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) - Kuptimi dhe objektivi i bashkëpronësisë, të drejtat e bashkëpronarit, administrimi i bashkëpronësisë dhe shuarja e bashkëpronësisë. Në këtë pjesë është trajtuar edhe pronësia e përbashkët sipas LPDTS-së si dhe pasuria e përbashkët sipas Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK-së) - Karakteristikat themelore dhe dallimet në raport me bashkëpronësinë, pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, sendet të cilat e përbëjnë pasurinë e përbashkët dhe pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Pasuria e fituar në bazë të kontratës aleatore, paraja, sendet e blera me kredi, dhuratat që u jepen bashkëshortëve, përgjegjësia për borxhet, administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët dhe ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Trajnimet u fokusuan në ofrimin e njohurive për

gjyqtarët mbi bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët në Kosovë si dhe trendet bashkëkohore, çfarë përbën pasuri e përbashkët e bashkëshortëve, natyra juridike e saj dhe cka është pasuria e veçantë e bashkëshortëve. Në vazhdim është zberthyer se çka përfshin kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe si të vendoset drejtë dhe në mënyrë ligjore në kontestet në mes të bashkëshortëve kur kanë mosmarrëveshje për pasurinë e përbashkët si dhe disa probleme aktuale në praktikën gjyqësore kosovare.

Gjithashtu u ofruan njohuri për praktikën gjyqësore të gjykatave kompetente lidhur me vendosjen e kontesteve pronësoro juridike sipas legjislacionit në fuqi duke u thelluar në konceptet kryesore të dala nga kjo praktikë. Përmes shpjegimeve u mundësua identifikimi dhe dallimi i lehtë i këtyre formave të së drejtave të pronësisë dhe vendosja e rasteve lidhur me to, e veçmas përcaktimi i të drejtave të pronarëve të përbashkët duke përfshirë edhe të drejtën e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët dhe mënyrën e pjesëtimit.

Në vazhdim u shpjegua zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në rastet e vërtetimit të kontributeve të bashkëshortëve të pronësia e përbashkët e bashkëshortëve si njëri ndër problemet e mëdha në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës.

Gjatë këtyre trajnimeve u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga ekspertët, përmes materialit të ofruar, analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus



në zbatimin e drejtë dispozitave ligjore në praktikë nga gjykatat kompetente si dhe përmes shpjegimeve të dispozitave ligjore për pronësinë e përbashkët, bashkëpronësinë dhe pasurinë e përbashkët”.

Përfitues në trajnimin në Pejë ishin gjyqtarët

dhe bashkëpunëtorët profesional të nivelit themelor nga Gjykata e Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit, ndërkaq në trajnimin në Prishtinë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional nga regjioni i Prishtinës.

Mundësia hetuese e veçantë

Më 4 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Mundësia hetuese e veçantë”.

Synimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me zhvillimin e procedurës penale dhe zbatimin sa më të suksesshëm të dispozitave ligjore që rregullojnë çështjen e institutit juridik të mundësisë së veçantë hetuese.

Gjatë trajnimit u trajtua mundësia hetuese e veçantë si kontribuese në tejkalimin e paqartësive që ekzistojnë në praktikën gjyqësore si në çështjet e marrjes në pyetje të palëve në procedurë dhe në analizimin e rasteve kur dëshmia e marr në hetimet e veçanta është provë e pranueshme për gjykatën, në të cilën mund të bazohet aktgjykimi. Përveç kësaj, u trajtuan edhe provat, shqyrtimi dhe pranueshmëria e provave të siguruara nga mundësia hetuese e

veçantë, si dhe përbërja e trupit gjykues në shqyrtimin e këtyre provave.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, si dhe bashkëpunorë profesional.



Etika Gjyqësore

Më 11 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Etika Gjyqësore” për gjyqtarë të cilët nuk e kanë përfunduar trajnimin obligativ gjatë vitit 2018.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve mbi Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë përmes diskutimeve dhe prezantimit të rasteve praktike. Në fokus të trajnimit ishte puna me raste hipotetike, duke identifikuar sjelljet e pahijshme dhe njëkohësisht duke zbërthyer dispozitat e Kodit të Etikës për Gjyqtar veçanërisht të

komunikimit midis një pale dhe gjyqtarit, përdorimi i mediave sociale, marrja e dhuratave, të cilat mund të krijojnë perceptimin e publikut se ekziston korrupsioni në sistemin gjyqësor.

Gjatë trajnimit si nga trajnuesit ashtu edhe nga pjesëmarrësit u theksua se gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm dhe të matur, në mënyrë që të veprojnë me integritet si në jetën e tyre private, ashtu edhe në jetën profesionale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kryetar dhe gjyqtarë të të gjitha niveleve nga të gjitha gjykatat e Kosovës.



Procedurat penale ndaj të miturit

Më 16 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “**Procedurat penale ndaj të miturit**”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me karakteristikat dhe specifikat që kanë të bëjnë me procedurën penale që zhvillohet ndaj një të mituri i cili ka rënë ndesh me ligjin.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin duke përfshirë edhe karakteristikat e procedurës penale që kanë të bëjnë me të miturit. Në vazhdim u vu në pah se nuk publikohet asnjë informacion që shpie në identifikimin e kryerësit të mitur që do të thotë se procedura penale që zhvillohet ndaj të miturit është

konfidenciale me qëllim të ruajtjes së intimitetit dhe personalitetit të të miturit. Vëmendje gjithashtu i'u kushtua edhe procedurës përgaditore në kuadër të së cilës ndërmerren veprime procedurale nga prokurori për të mitur duke përfshirë dhe kohëzatjen e procedurës përgaditore si dhe paraqitjen e propozimit nga prokurori për të mitur apo hudhjen e kallximit penal.

Në pjesën e pasditës u trajtua shqyrtimi gjyqësor, karakteristikat dhe elementet dalluese që përbëjnë këtë fazë të procedurës penale që zhvillohet ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar dhe prokuror nga niveli themelor nga të gjitha regionet e Kosovës.



Trajnim për aftësitë ligjore për prokuroret e rajonit të Mitrovicës: Sfidat e prokurorëve të këtij rajoni dhe Kodi i ri Penal me theks të veçantë dispozitat e reja me ndryshimet legislative

Më 16-19 prill 2019 në Durrës të Shqipërisë, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), në mbështetje të OSBE-së ka realizuar trajnimin për prokurorët e regjionit të Mitrovicës me temë: Sfidat e prokurorëve të rajonit të Mitrovicës dhe Kodi i ri Penal me theks të veçantë dispozitat e reja me ndryshimet legislative.



Në hapje të këtij trajnimi në fillim mori fjalën Ilija Bundaleski Drejtor regjional i Misionit të OSBE-së në Mitrovicë, i cili në fjalën e tij mes tjerash theksoi rëndësinë e këtij trajnimi duke qenë se është në fokus Kodi i ri Penal dhe dispozitat e reja veçanërisht veprat e reja penale.

Në vazhdim mori fjalën Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksander Lumezi i cili në fjalën e tij kryesisht foli rreth vështirësive në punë si dhe hyrjes në fuqi të Kodit Penal i cili ka ndryshime si në aspektin material dhe procedural ashtu edhe vepra të reja penale të cilat janë të rëndësishme për punën e prokurorit. Vëmendje të veçantë gjatë fjalës së tij iu dha edhe veprave korruptive, politikës ndëshkimore dhe rolit të prokurorit në zbatimin e hetimeve dhe ngritjen e aktakuzave. Më pas mori fjalën Shyqyri Sylja kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë i cili në fjalën e tij mes tjerash falënderoi OSBE-në për bashkëpunimin veçanërisht në sundimin e ligjit, mbështetjen në

procesin e integritetit dhe mbështetjen e vazhdueshme qoftë me trajnime qoftë në forma tjera. Në fund të pranishmëve iu drejtuar Laura Pula, prokurore në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit e cila i përshëndeti organizatorët e këtij trajnimi, Kryeprokurorin e Shtetit, pjesëmarrësit dhe Akademinë e Drejtësisë e më pas u fokusua te pikat dhe objektivat e këtij trajnimi duke kërkuar interaktivitet nga pjesëmarrësit.

Gjatë këtij trajnimi në ditën e parë kryesisht është diskutuar për sfidat dhe vështirësitë në punën e përditshme të prokurorëve nga rajoni i Mitrovicës që nga fillimi i punës pas luftës, numri i vogël i prokurorëve, pastaj organizimi i ri i prokurorisë sipas ligjit, integrimi i prokurorëve dhe stafit administrativ sipas marrëveshjes së Brukselit e deri në ditët e sotme. Në vazhdim u potencua edhe nevoja e përkthimit të lëndëve për të cilën ka qenë sfiduese duke qenë se kanë pasur pak përkthyes por që me angazhimin dhe mbështetjen e donatorëve dhe KPK kanë arritur të rrisin numrin e përkthyesve.

Me rastin e këtij trajnimi si sfidë e veçantë është identifikuar edhe numri i madh i gjyqtarëve nëpër gjitha degët, e që prokurorët ngarkohen me ftesa nëpër gjykime duke pasur shumë pak kohë të punojnë në zyre për lëndët e reja, meqë numri i prokurorëve është më i vogël në proporcion me gjyqtarët. Më tej, pavarësisht këtyre sfidave u tha që është punuar dhe ka rezultate meqë prokurorët kanë kryer lëndë me normë të dyfishuar gjë që gjatë vitit 2018, 92% e aktakuzave kanë kaluar me aktgjykim dënues.



Në vazhdim të këtij trajnimi për tri ditë tjera me radhë janë identifikuar ndryshimet në Kodin Penal duke vënë në pah se janë rritur dënimet te një numër shumë i madhe i veprave penale, janë parashikuar vepra të reja penale si dhe janë riformuluar mjaftë nene për t'i bërë më të qarta dispozitat e tyre. Vëmendje të veçantë kryesisht i është kushtuar dhunës në familje e cila tashmë është paraparë si vepër penale duke pasur parasysh se është dukuri shumë e shpeshtë në shoqërinë tonë. Si rezultat i të gjeturave nga hulumtimet u tha që rastet më të shpeshta të kësaj dukurie janë në regjionin e Ferizajt, Mitrovicës dhe Prishtinës. Më tej u elaboruan elementet e veprës penale dhunë në familje duke sqaruar se çfarë është dhuna fizike, dhuna psikologjike, dhuna seksuale dhe dhuna ekonomike.

Në vazhdim u diskutua edhe për rolin e prokurorit në ndjekjen penale të këtyre rasteve, për procedurën, të drejtat e viktimës etj. Në kuadër të këtij trajnimi janë elaboruar edhe tiparet e ngacmimit seksual sipas Kodit Penal. Nga pjesëmarrësit u ngritën mjaftë çështje të cilat paraqesin vështirësi për prokurorët duke vënë në pah mungesën e koordinimit institucional në mes të prokurorisë dhe Qendrës për Punë sociale, pastaj mungesën e

mekanismave për trajtimin e mëtutjeshëm të viktimave të dhunës por edhe të kryesit të veprave penale dhunë në familje etj.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes punës në grupe dhe rasteve për studim të dhunës në familje të identifikojnë elementet e veprës penale të dhunës në familje si dhe mënyrën e trajtimit të këtyre rasteve sipas ligjit të ri.

Në fund të këtij trajnimi u elaboruan edhe masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale duke i trajtuar veq e veq secilën masë dhe njëkohësisht duke vënë në pah dispozitat ligjore. Gjithashtu u nxjerrën konkludimet përfundimtare mbi çështjet e identifikuar veçanërisht:

- për mospërputhjen e Kodit Penal, versioni në shqip me atë serbisht gjë që u kërkua t'iu referohen dispozitave burimore, pra versionit në shqip deri sa të harmonizohen,
- nevoja për hartimin e një doracakut për mënyrën e trajtimit të dhunës në familje sipas Kodit Penal në fuqi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët dhe stafi administrativ i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Procedura në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Më 17 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të (PTV), ka realizuar trajnimin me temë “Procedura në KPMSHCK dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet e punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e drejt të legjislacionit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë lëmi dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur në procedurë gjyqësore si dhe evitimin e dilemave lidhur me dispozitat ligjore përkatëse.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: dispozitat ligjore për shërbyesit civil; procedura ligjore në KPMSHCK, përbarimi i vendimeve të KPMK-së dhe mjetet juridike kundër këtyre vendimeve si dhe procedura në rastet e mos zbatimit të vendimeve të KPMK-së.

Në pjesën e dytë të trajnimit, u trajtuan: procedurat gjyqësore në kontestet e marrëdhënies së punës për shërbyesit civil, sipas padisë për konflikt administrativ, aktgjykimi në konfliktin administrativ dhe mjetet juridike në konfliktin administrativ si dhe raste nga praktika gjyqësore lidhur me procedurën në çështjet që lidhen me shërbyesit civil.

Fokusi në këtë trajnim ishte tek procedura që

zhvillohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (KPMK) dhe mbrojtja gjyqësore në kontestet nga marrëdhënia e punës me përqendrim tek Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës kur cenohen të drejtat e shërbyesve civil. Për këtë u potencua se si në KPMK dhe në gjykata ka dilema dhe paqartësi lidhur me kompetencën për të vendosur në këto konteste. Po ashtu, ka vështirësi që kanë të bëjnë me moszbatimin e disa vendimeve të Këshillit, përbarimin e vendimeve nga gjykatat dhe zbatimin e standardeve kushtetuese për të drejtën në punë. Me dobi në këtë trajnim ishin edhe analiza e vendimeve dhe interpretimet në këtë temë që kanë dhënë gjykatat e rregullta, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese përmes sqarimeve të trajnuesve.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore dhe përmes analizës së tyre të elaborojnë dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat gjyqësore në kontestet e marrëdhënies së punës për shërbyesit civil.

Përfitues ishin gjyqtarët e departamentit administrativ të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme në gjykatat themelore dhe bashkëpunëtorët profesional si dhe zyrtarët e KPMK-së.



Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP

Më 18 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë "Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit të subjekteve nga AKP".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurat e privatizimit të subjekteve nga Agjencia Kosovare e Privatizimit si dhe mbi rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit; verifikimin dhe shpalljen e fituesit të përkohshëm; aprovimin dhe refuzimin e ofertës; dhe ofertuesit me ndalesa ofertimi.

Në këtë trajnim u shqyrtua edhe gjendja e përgjithshme në Kosovë që i parapriu paraqitjes së nevojës për privatizimin dhe likuidimin adekuat dhe me kohë të ndërmarreve në pronësi shoqërore. Gjithashtu trajnimi ofroj përgjigje edhe në pyetjet: A ka shkelje të procedurave nga

AKP, me rastin e aprovimit apo refuzimit të ofertave? Në çfarë gjendje ndodheshin NSH-të në Kosovë pas luftës, sa ishin borxhet e tyre? Cilat janë vështirësitë e gjyqësorit në zgjidhjen e rasteve të kësaj natyre që paraqiten para saj?


Po ashtu gjithanshëm u trajtua dhe u analizuan problemet aktuale në praktikë, duke njohur dhe kuptuar më mirë rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit në Kosovë. Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit u trajtuan në thellësinë e tyre përmes diskutimeve të pjesëmarrësve dhe të trajnuesve duke nxjerr përfundime adekuate.

Përfitues në këtë trajnim ishin: Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil, zyrtaret ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional.



Kodi i ri i Drejtësisë për të mitur

Me 18 dhe 19.04.2019 Akademia e Drejtësisë e mbështetur nga UNICEF, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoj dy trajnime me temë: “Kodi i ri i Drejtësisë për të Mitur”.



Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte inkurajimi i zyrtarëve të policisë dhe prokurorëve për të mitur, në aplikimin e masave të diversitetit për të miturit, si një nga masat më efektive dhe të përshtatshme për fëmijët në konflikt me ligjin që është në zbatim, dhe kriterëve ligjorë të përcaktuara nga Kodi i Drejtësisë për të Mitur për garantimin dhe mbrojtjen e të gjitha të drejtave të tyre sipas standardeve ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut.

Çështjeve që i kushtua më shumë vëmendje ishin parimet e Kodit të Drejtësisë për të Mitur,

çështja e ndërmjetësimit, masat e diversitetit dhe llojet e tyre. Gjithashtu u diskutua rreth risive të cilat janë të pranishme tani me Kodin e ri të Drejtësisë për të Mitur si dhe procedurat të cilat duhet zhvilluar që zbatimi të jetë i drejtë dhe në përputhshmëri me ligjin.

Metodologjia e aplikuar në trajnim ishte e kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive ku përfituesit e këtij trajnimi u informuan rreth risive dhe procedurës që duhet aplikuar në rastet që ata ballafaqohen gjatë ushtrimit të profesionit.

Përfitues të këtij trajnimi në ditën e parë ishin prokurorët dhe policët hetues nga regjioni Prishtinës, Gjilanit dhe Ferizajt, ndërsaq në ditën e dytë prokurorët dhe policët hetues nga regjioni i Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare

Më 23-24 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të (PTV) me përkrahjen e UNICEF-it ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore – familjare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin e mbrojtjes efikase dhe efektive të të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit dhe zbatimin e drejtë të ligjit me rastin e besimit, ruajtjes dhe kujdesit të fëmijëve.

Në ditën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: parimet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtarë, kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijëve dhe parimet për përcaktimin e alimentacionit. Ndërsa në ditën e dytë të trajnimit, u trajtuan: roli aktiv që duhet të ketë gjykata në këto konteste dhe rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve në çështjet civile-procedura.

Në këtë trajnim fokusi ishte tek kontestet martesore-familjare dhe numri i tyre që vazhdimisht është në rritje në gjykatat tona. U konkludua se kontestet martesore-familjare janë mjaft komplekse për shkak të natyrës së tyre dhe se roli i gjykatës në këto konteste nuk është vetëm shqyrtues por edhe hetues. Krahas analizimit të rolit të gjykatës në kontestet

martesore-familjare u trajtua edhe rrëmbimi i fëmijëve pasi kjo tematikë në vitin 2010 është rregulluar me ligj, që është një risi për sistemin tonë gjyqësor.

Përmes analizës krahasuese për pjesëmarrësit u ofruan rekomandime për rolin aktiv që duhet të ketë gjykata në rastet kur pjesë e procedurave janë të miturit. Në këtë kontekst u potencua se gjyqtarët dhe kuadri tjetër i cili përfshihet në procedurat ku shtrohet nevoja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve duhet të jenë në gjendje që me kompetencë profesionale e duke zbatuar standardet më të lartat vendore e ndërkombëtare, fëmijëve t’u ofrojnë mbrojtjen e të drejtave sipas parimit të interesit më të mirë për të miturit, i cili parim duhet të jetë pikësynim mbizotërues në çdo rast dhe procedurë.

Në këtë trajnim duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore u ofruan përgjigje në pyetjet dhe dilemat, duke analizuar legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar mbi çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore–familjare.

Përfitues ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, gjyqtarët e Gjykatave Themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët e Organit të Kujdestarisë.

Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet

Më 25 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua procedura në kontestet e pengim posedimit dhe të drejtës së servitutit si dhe elementet e aktit të pengim posedimit dhe servitutit.

Në pjesën e dytë u trajtuan afatet për mbrojtje gjyqësore në kontestet e pengim posedimit dhe te servitutet si dhe raste nga praktika gjyqësore lidhur me këto konteste.

Në trajnim gjithanshëm u trajtua aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet.

Gjatë trajnimit u potencua se në procedurën që zhvillohet për kontestet për shkak të pengim posedimit, si procedurë e posaçme kontestimore që është rregulluar me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata i jep mbrojtje gjyqësore personit të cilit i është marrë sendi nga posedimi apo të cilit i shkaktohen pengesa gjatë shfrytëzimit të tij. Me dispozitat ligjore të përmendura mundësohet rivendosja e shpejtë dhe efikase e gjendjes faktike të çrregulluar, ku shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit nga gjykata do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë.

Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.



Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 25-27 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së (Departamenti Ligjor i SHBA-së) ka realizuar trajnimin me temë “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njohja e përfituesve me dispozitat e reja ligjore të Kodit Penal për zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Gjatë trajnimit për tre ditë me radhë janë trajtuar ndryshimet legislative duke analizuar ndryshimet që kanë të bëjnë me veprat penale kundër shërbimeve komunale, veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe nenet e reja që janë përfshirë në Kodin Penal i cili ka hyr në fuqi.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe ndryshimeve që priten të bëhen në Kodin e Procedurës Penale, siç është mbrojtja e detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, hudhja e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar hudhjen, masat e veçanta hetimore, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë. Po ashtu u diskutua dispozita e re që rregullon suspendimin e personit zyrtar nga detyra, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit, gjykimi në mungesë, seanca për caktimin e dënimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtar, prokuror, avokat dhe mbrojtës të viktimave nga regjioni i Prizrenit.



Menaxhimi i kohës si predispozitë në menaxhimin e stresit

Më 30 prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temë “Menaxhimi i kohës si predispozitë në menaxhimin e stresit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me menaxhimi e kohës si predispozitë në menaxhimin e stresit.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan: Faktorët e stresit, llojet e stresit, shenjat dhe simptomat paralajmëruese të stresit. Ndërsa në pjesën e dytë të trajnimit u trajtuan: stresi në punë dhe administrimi i kohës.

Që në fillim u potencua se jeta e përditshme në botën moderne shoqërohet me paraqitjen e stresit dhe llojeve të ndryshme të tij, e sidomos kur kemi të bëjmë me ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit. Stresi paraqitet si një tërësi e reagimeve emocionale, trupore dhe të sjelljes ndaj atyre kërkesave, sfidave dhe ngarkesave të cilave individi u nënshtrohet në rrethana të ndryshme të punës e jetës. Në përgjithësi stresi është pasojë dhe tregues i një “ngufatje” të jetës shpirtërore. Prezenca e shpeshtë e stresit në përditshmërinë e individit shkakton de-motivimin, redukon produktivitetin, dobëson performancën, shkakton probleme mentale fizike dhe ndryshon sjelljen e individit.

Në vazhdim u konkludua se menaxhimi i mirë i kohës dhe prioritizimi i nevojave janë nga predispozitat e menaxhimit të mirë dhe mbajtjes nën kontroll të vazhdueshëm të stresit si parakusht i ruajtjes së shëndetit dhe mirëqenies

së individit. Shumë njohës të kësaj problematike preferojnë vendosjen e kufijve si teknikë e parandalimit të efektit negativ të stresit. Vendosja e kufijve material dhe formal, si dhe përmbajtja e kufijve emocional janë elementet e përmbajtjes së kësaj teknike.

Në këtë trajnim u shtjellua edhe tematika e zhvillimit të shkathtësive të ruajtjes së shëndetit, kultivimit të vlerave profesionale dhe ruajtja e balancit emocional e mental si predispozita të ushtrimit të suksesshëm të profesionit të gjyqtarit dhe prokurorit.

Po ashtu temë fokusi ishte edhe djegja profesionale, apo konsumimi profesional, dekadencia morale si dhe aftësimi për rezistimin dhe tejkalimin e suksesshëm të situatave stresuese. U konstatua se kultivimi i një fryme inkurajuese e stimuluese në mjedisin e punës për përmbushjen sa ma cilësore të detyrave të punës ndikon në ushtrimin dinjitoz të funksionit të gjyqtarit dhe prokurorit.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të teorik, duke u bazuar në raste studimore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e metodave efikase për menaxhimin e mirë të kohës si predispozitë e menaxhimit të stresit.

Përfitues ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VI)

Sipas programit trajnues në kuadër të trajnimit teorik gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata e gjashtë kanë realizuar gjithsejtë 18 sesione trajnuese nga modulet: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës dhe Kodi Penal.



Nga nën moduli: “Provat në procedurën penale” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese, ku u diskutuan çështjet e provave dhe mjeteve provuese, klasifikimi i provave, i pandehuri, dëshmitarët dhe llojet e tyre, provat e papranueshme, marrja e provave nga ekspertët dhe kundërthëniet mes tyre.

Nga nën moduli: “Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese ku u trajtuan: Caktimi i gjyqtarit për gjykimin e çështjes, kontrollimi i kompetencës dhe aktakuzës, procesverbali i shqyrtimit fillestar, çështja e mbrojtjes dhe provave, marrëveshja për pranimin e fajësisë, prishja e rendit dhe mosbindja ndaj urdhrave të gjykatës, kundërshtimet për hedhjen poshtë të aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor dhe rrjedha e tij, fjala përfundimtare dhe seanca për këshillim dhe votim.

Nga nën moduli: “Parashkrimi” janë realizuar tri (3) sesione trajnues dhe janë trajtuar këto çështje: kohëzgjatja e parashkrimit sipas Kodit Penal, ndërprerja dhe ndalja e parashkrimit sipas Kodit penal, parashkrimi absolut i ndjekjes penale, si dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit etj.

Nga nën moduli: “Procedura sipas mjeteve juridike” është realizuar një (1) sesion trajnues dhe gjyqtarët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohurit e tyre rreth: Mjeteve të rregullta juridike dhe të jashtëzakonshme juridike, kërkesa për rishikim të procedurës, kërkesa për zbutjen e dënimit, si dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Nga nën moduli: “Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave” është realizuar një (1) sesion trajnues, dhe fokusi ka qëndruar tek procedura për marrjen e vendimeve në seancë për këshillim dhe votim nga trupi gjykues, seanca e mbyllur për këshillim dhe votim, shkresat e doëzuara pas afatit, dhe dorëzimi i shkresave nëpërmjet pjesëmarrësve të tjerë në procedurë.

Gjithashtu nga nën moduli: “Shpenzimet e procedurës dhe kërkesat pasurore juridike” është realizuar një (1) sesion trajnues dhe janë trajtuar këto çështje: Aktvendimi për shpenzimet e procedurës penale, pagimi i shpenzimeve sipas fajit të personit që i ka shkaktuar, shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose të përfaqësuesit të autorizuar, paraqitja e propozimit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, masat për sigurimin e përkohshëm të dhe kërkesës pasurore juridike të drejtuar kundër personave të tretë.

Gjatë muajit Prill gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar edhe një vizitë në Institucionin e “Doganës së Kosovës”

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 8 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur pesë (5) gjyqtarë të komunitetit serb.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga moduli: E drejta civile, administrative dhe ekonomike.

Nga nën moduli: Procedura Kontestimore – pjesa e parë janë realizuar katër (4) sesione trajnuese ku u trajtuan: Përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës, forma e prerë e aktgjykimit dhe korigjimi i tij, llojet e aktgjykimeve sipas LPK-së, si dhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve.

Nga nën moduli: “Procedura Kontestimore – pjesa e dytë janë realizuar tetë (8) sesione trajnuese dhe janë diskutuar këto çështje:

Paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë, shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi, përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor, mjetet provuese dhe marrja e provës, dhe sigurimi i kërkespadiës.

Gjithashtu nga nën moduli: “E drejta Familjare” janë realizuar katër (4) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar kanë trajtuar strukturat farefisnore, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, zgjidhja e martesës/procedura e shkurorëzimit, si dhe vërtetimi dhe kundërshtimi i atësisë dhe amësisë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 9 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit Prill 2019, në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete në trajnimin praktik.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (5) ditë trajnimi praktikë në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues.

Data 05 Prill 2019 ka shënuar edhe përfundimin

zyrtar të trajnimit 12 mujor në Akademinë e Drejtësisë nga Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VII-të), 2018-2019.

Trajnimin fillestar e kanë ndjekur 21 prokuror të sapo emëruar, dy prej tyre janë të komunitetit serb.



Raporti i vizitës së gjyqtarëve të sapo emëruar (Gjenerata VII) në Doganën e Kosovës

Më 23 prill 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare, organizoi për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) vizitë në “Doganën e Kosovës”.



Qëllimi i kësaj vizite ishte që gjyqtarët të njoftohen për së afërmi me, infrastrukturën ligjore, punën, veprimtarinë dhe problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion.

Në kuadër të kësaj vizite, shkurtimisht u elaborua historiku dhe procesi i zhvillimit të Doganës, roli dhe misioni i saj, legjislacioni mbi të cilin ushtron kompetencat e saj, struktura organizative si dhe bashkëpunimi me institucionet tjera të zbatimit të ligjit.

Me tej, u diskutuan çështjet praktike në sistemin e të drejtës penale në fushën e doganave,

krahasimin e neneve përkatëse të Kodit Penal dhe Kodit Doganor që rregullojnë këtë materie, ku u paraqiten sfidat aktuale që has Dogana e Kosovës në këtë fushë. Në këtë kuadër, po ashtu u diskutua rreth mënyrave adekuate të bashkëpunimit dhe avancimit të tij, me qëllim luftimin e suksesshëm dhe ndëshkimin e dukurive negative të kësaj natyre

Si përfundim u paraqitën edhe problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Dogana e Kosovës, në veçanti problemet me luftimin e kontrabandës, futja e narkotikëve, zbatimi dhe funksionalizimi i marrëveshjes së stabilizim asocimit dhe marrëveshjes së CEFTA-së, parashikimi se si do të funksionojë sistemi doganor në të ardhmen pas futjes së Kosovës në Bashkimin Evropian dhe heqjes së barrierave doganore, ku siç dihet rreth 70% e buxhetit të vendit mbushet nga të hyrat doganore.

I tërë trajnimi u realizua në mënyrë interaktive mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve.

Përfitues të trajnimit ishin Gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata VII) 2019-2020.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Sistemi Gjyqësor – struktura dhe kompetenca

Më 18 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit Vazhdueshëm për staf administrativ të gjykatave, organizoj trajnimin me temë “Sistemi Gjyqësor struktura dhe kompetencat”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me kompetencat, mandatin, planifikimin, organizmin, kontrollin dhe kornizën ligjore për menaxhimin e administratës gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua menaxhimi dhe udhëheqja, dallimi në mes të menaxhimit dhe udhëheqjes, nivelet e menaxhimit, menaxhimi në administratën e sistemit gjyqësor, planifikimi si dhe vendimmarrja.

Në këtë trajnim po ashtu janë trajtuar llojet e planeve në sistemin gjyqësor dhe efekti reciprok i tyre, planifikimi i burimeve njerëzore, buxhetit, shërbimeve dhe infrastrukturës, struktura dhe përmbajtja e një plani standard.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç’rast pjesëmarrësit patën rastin të bëjnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin stafi administrativ i gjykatave e të gjitha niveleve.



Sistemi prokurorial – struktura dhe kompetencat

Më 19 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit Vazhdueshëm për staf administrativ prokurorial, organizoj trajnimin me temë “Sistemi prokurorial – struktura dhe kompetencat”

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me kompetencat, mandatin, planifikimin, organizmin, kontrollin dhe kornizën ligjore në menaxhimin e administratës të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

Gjatë këtij sesioni trajnues u trajtua: Menaxhimi dhe udhëheqja, dallimi në mes të menaxhimit dhe udhëheqjes, nivelet e menaxhimit, menaxhimi në administratën e sistemit prokurorial, pla-

nifikimi dhe vendimmarrja, planifikimi i burimeve njerëzore, buxhetit i shërbimeve dhe infrastrukturës, struktura dhe përbajtja e një plani standard.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësi të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në punën e tyre të përditshme.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Zyrtarët ligjorë (përfshirë zyrtarët ligjor të sekretariateve), referentët administrativ dhe zyrtarët për komunikim me mediat dhe publikun.



Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor

Me 24-25.04.2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), organizoi trajnimin dy (2) ditor me temë “Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive në zbatimin e standardeve adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes përmes hartimit të planeve, marrjes së vendimeve të arsyeshme dhe krijimit të ambientit për punë kreative dhe të suksesshme

Çështjeve që i ‘u kushtua më shumë vëmendje ishin menaxhimi i punës dhe udhëheqja, planifikimi i punës dhe vendimmarrja, procedurat e brendshme dhe të jashtme të punës. U diskutua gjithashtu për problemet në administratat e gjyqësorit, dhe vështirësitë që ballafaqohen zyrtarët gjatë ushtrimit të profesionit të tyre si

dhe u inkurajuan që të jenë të gatshëm të menaxhojnë situatat stresuese dhe punën në presion.

Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive ,ku trajnuesit ndanin eksperiencat e tyre duke transmetuar njohurit e tyre për punë më efikase dhe në përputhshmëri me ligjin.

Përfitues të këtij trajnimi dy ditor ishin ndihmës-administratorët, referentit e Gjykatave Themelore dhe degëve të tyre nga të gjitha regionet e Republikës së Kosovës.



Moduli 2 – Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial

Më 26 dhe 27 Prill 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), ka realizuar trajnimin me temë: “Moduli 2 – Menaxhimi i punës në administratën e sistemit prokurorial”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i praktikave më të mira të planifikimit, menaxhimit dhe vendimmarrjes duke zbatuar detyrat e punës sipas rregullave të përcaktuara në bazë të objektivave të Këshillit Prokurorial.

Në kuadër të këtij trajnimi janë trajtuar menaxhimi dhe udhëheqja, planifikimi dhe vendimmarrja, proceset e brendshme dhe të jashtme të punës si dhe efikasiteti dhe llogaridhënia e stafit administrativ.

Gjatë diskutimit u vlerësuan proceset dhe procedurat e brendshme dhe u rekomanduan ndry-

shime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës. Pra një vëmendje e veçantë iu kushtua sugjerimeve të tyre në gjetjen e mënyrave për ndryshim dhe përmirësim.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit patën rastin që përmes punës të ndarë në tre grupe duke shfrytëzuar njohuritë që morën gjatë ditës së parë të trajnimit si dhe nga përvojat personale të shpalosin idetë e tyre për një organizim dhe përfundim sa më të mirë të detyrave të punës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin udhëheqësit e njësive organizative të Sekretariatit të Këshillave (SKPK), stafi i njësitet për shqyrtimin e performances së Prokurorisë, ndihmës administratorët, administratorët e prokurorive dhe udhëheqësit e shkrimoreve.



Aktivitetet tjera

Konferenca Rajonale- Nxitja e trajnimit gjyqësor në Ligjin Tatimor në Gjykatat e Ballkanit Perëndimor

Nga data 04- 05 Prill 2019, është mbajtur Konferenca Rajonale për Ballkanin Perëndimor me temë: Nxitja e Trajnimit Gjyqësor në Ligjin Tatimor në Gjykatat e Ballkanit Perëndimor.



Në këtë konferencë janë trajtuar sfidat dhe arritjet e fushës së drejtës tatimore, drejtës tregtare dhe aftësitë e kontabilitetit.

Më tej është vënë në pah edhe aspekti i trajnimit gjyqësor veçanërisht fushat me prioritet, mësimi në distancë, kohëzgjatja e trajnimit, profili i trajnuesit dhe ndikimi i vlerësimit në trajnim.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit nga konferenca kanë vizituar Institutin e Drejtësisë së Bullgarisë në të cilin për së afërmi janë njoftuar me zhvillimin e trajnimeve, përzgjedhjen e trajnuesve dhe çështjet tjera lidhur me trajnimet.

Në këtë konferencë me ftesë të Institutit Kombëtar të Drejtësisë së Bullgarisë, Miglena Tacheva, nga Kosova ka marrë pjesë gjyqtari Ramush Bardiqi i cili me paraqitjen e tij ka prezantuar perspektivën Kosovare sa i përket kësaj fushe.



Konferenca Përmbyllëse e Projektit JUFREX

Më dt. 04-06 prill 2019 në Sarajevë, është realizuar Konferenca Përmbyllëse e Projektit “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Medies në Evropën Jug – Lindore (JUFREX)” i financuar nga Këshilli i Evropës.

Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi i lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës me një përqendrim të veçantë në degën e gjyqësorit në Evropën Juglindore.

Në konferencën përmbyllëse të projektit, morën pjesë të gjitha vendet e rajonit që ishin përfituese dhe diskutuan zhvillimet më të fundit në GJEDNJ, lidhur me lirinë e shprehjes, për praktikatat më të mira gjyqësore, autoritete rregullative dhe aktorët e medias. Gjithashtu janë raportuar dhe analizuar aktivitetet e realizuara si dhe përvojat gjatë implementimit të

projektit si dhe sfidat e hasura në këtë fushë.

Në përmbyllje të aktivitetit është realizuar mbledhja e Këshillit Drejtues, dhe shtetet përfitues të këtij projekti konkretisht Akademitë/ Shkollat gjyqësore, kanë raportuar për të arriturat, sfidat si dhe synimet për të ardhmen. Po ashtu në këtë mbledhje u njoftuan se ky projekt planifikohet të zgjatë edhe për tri vjet të ardhshme ku do të fokusohet në trajtimin më të hollësishëm të nevojave të identifikuara gjatë projektit të parë.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet nga shteti i Kosovës ishin: Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, U.D Koordinatori i Programit në AD, gjyqtarë, prokuror (njëheritë trajnues të Akademisë) si dhe avokat dhe përfaqësues nga asociacioni i mediave.



Tryeza e rrumbullakët rajonale: Vlerësimi i trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut për ekspertët juridik –sfidat dhe shembujt e praktikës së mirë

Më 11 dhe 12 prill 2019, organiuar nga Këshilli i Evropës në Mal të Zi është realizuar tryeza e rrumbullakët rajonale me temë : Vlerësimi i trajnimeve në fushën e të drejtave të Njeriut për ekspertët juridik –sfidat dhe shembujt e praktikës së mirë ”.



Qëllimi i kësaj tryeze ishte trajtimi i sfidave kyçe të vlerësimit të ndikimit afatëgjatë të trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut nga autoritetet kombëtare me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe

prokurorëve të shteteve.

Gjatë kësaj tryeze vëmendje iu kushtua aplikimit të neneve të Konventës Evropiane të Drejtave dhe Lirive të Njeriut duke përfshirë edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut në vendimet e gjykatave kombëtare. Paraprakisht, u trajtua edhe vlerësimi i ndikimit afatëgjatë të trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe disponueshmëria, mundësia e qasjes dhe e përdorimit të mjeteve për trajnim në kuadër të trajnimit në fushën e të drejtave të njeriut për sistemin gjyqësor dhe atë prokuroral.

Përfitues të kësaj tryeze ishin përfaqësues të qendrave të trajnimit si dhe Këshillit Gjyqësor të shteteve nga Ballkani si nga Shqipëria, Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut, si dhe nga Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës.

<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**